

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Nuk shitet Shqipëria"/ 99 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kë rkon revolucion
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/nuk-shitet-shqiperia-99-dite-revolte-qytetaret-nuk-e-ndalin-reziste-i512827
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 17:50:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 17:47:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1efeb1ce642a9b074d17d8c4406b3e69d3114b9b0099fb650a61e01e19057620
TEKSTI	88a949c5ac96a396cfa42d2ad3a19c2b82065fb08ea442aeb1e0d148754f7aae
PAMJA	87aa9c586e31047773def46f879ff1e93ba8613f937beefb148df9e4e125c0ec

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	571f99a1f60324334a26b441ac074b6e06de95b0067b3f2161354dd64d925092
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00a00f473eee6089e629c3fbe5b781cecb40006581d22ebdfab6238166e5deac
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/571f99a1f60324334a26b441ac074b6e06de95b0067b3f2161354dd64d925092>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [KREU](#)
- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKE](#)
- [EKONOMI](#)
- [BOTA](#)
- [SPORT](#)
- [ART&ARGËTIM](#)
- [INSIGHTS](#)
- [EDITORIAL](#)



Mundesuar nga

LIVE UPDATES
3 ORE ME PARE LIVE UPDATES E. D

["Nuk shitet Shqipëria"/ 99 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion](#)

"Dy kërkesa janë urgjente, dorëheqja e Ramës dhe qeveria teknike"/ Protestuesi: Nesër 100-ditëshi, protestë k...

4 ORE ME PARE LIVE UPDATES E. D

["Diaspora në SHBA, fat i mirë i kombit shqiptar"/ Berisha me shqiptarët në New Jersey: Ata që firmosën ndalimin tim, sot janë non-grata në vendin e tyre](#)

Berisha nga SHBA: Nga kjo platformë kam një kushtim për të gjithë shqiptarët në botë, Shqipëria du...

5 ORE ME PARE LIVE UPDATES E. D

[Zjarret në vend/ Flakët "përprijnë" masivin pyjor në Tërbus të Pukës, rrezikohet 'kurora' e qytetit! Situata problematike edhe në Fier \(PAMJET\)](#)

Vatër zjarri në kodrat e Peshkëpisë në Selenicë, era favorizon përhapjen e flakëve 6 Shtator, 16:26 ...

6 ORE ME PARE LIVE UPDATES E.D

[Operacion anti-drogë në Sarandë/ Arrestohen 20 persona, mes tyre 'koka' e grupit Altin Arapi! Shisnin hashash e kokainë pranë plazheve \(EMRAT+PAMJET\)](#)

Zbulohet si funksiononte skema e shitjes së drogës në Ksamil, anëtarët e grupit vinin nga Tirana dhe Elbasani vetë...

LIVE UPDATES

"Nuk shitet Shqipëria"/ 99 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion

• Protestuesit janë mbledhur sot në protestën e 99-të radhazi për largimin e Kryeministrit Edi Rama. • Fillimisht qytetarët janë mbledhur në Sheshin "Skënderbej" dhe më pas kanë marshuar drejt kryeministrit, aty ku dhe kanë mbajtur fjalimet e tyre. • Protestuesit kërkojnë ndryshim të gjithë klasës politike, mesazh të cilën e kanë përcjellë prej 99 ditësh me thirrjen "Rama në burg, Berisha në burg". • Pas përfundimit të fjalimeve para kryeministrit, qytetarët kanë nisur marshimin në rrugët e Tiranës. • Pavarësisht 99 ditëve të protestave, protestuesit deklarojnë se nuk do të tërhiqen dhe se do të vijojnë qëndresën deri në realizimin e kërkesave të tyre. • Aktivistët kanë bërë thirrje për pjesëmarrje masive në ditën e 100-të, ndërsa është paralajmëruar rrethimi i Kryeministrit. • Protestuesit kanë sinjalizuar gjithashtu se aksioni do të zhvendoset edhe përpara Parlamentit me rinisjen e sesionit parlamentar. • "Arrestoni Ramën", "O Ergys o legen prite Ramën se po vjen", "Edi Rama frikacak", "Dorëheqje, ju erdhi fundi", "Policia e krimit", "Edi Rama jep dorëheqjen", "Edi Rama në burg", "O Erion o legen prite Ramën se po vjen", "Shqipëria e shqiptarëve, vdekje tradhtarëve", "Pa rini nuk ka Shqipëri", "Poshtë patronazhistët" dhe "Shqipëria kërkon revolucion", janë disa nga thirrjet kryesore që protestuesit kanë brohoritur në kor gjatë tubimit.

7 artikuj për këtë temë.

1 ORE ME PARE

"Rama në burg", qytetarët vijojnë marshimin: Studentët kërkojnë revolucion

"Nuk shitet Shqipëria"/ 99 ditë revoltë,
pamjet

TIRANË- Me thirrjet "Rama në burg" dhe "Studentët kërkojnë revolucion", qytetarët po vijojnë marshimin në rrugët e Tiranës. Protestuesit kanë bërë thirrje për pjesëmarrje masive në ditën e 100-të, ndërsa është paralajmëruar rrethimi i Kryeministrit. Ata kanë sinjalizuar gjithashtu se aksioni do të zhvendoset edhe përpara Parlamentit me rinisjen e sesionit parlamentar.

"Arrestoni Ramën", "O Ergys o legen prite Ramën se po vjen", "Edi Rama frikacak", "Dorëheqje, ju erdhi fundi", "Policia e krimit", "Edi Rama jep dorëheqjen", "Edi Rama në burg", "O Erion o legen prite Ramën se po vjen", "Shqipëria e shqiptarëve, vdekje tradhtarëve", "Pa rini nuk ka Shqipëri", "Poshtë patronazhistët" dhe "Shqipëria kërkon revolucion", janë disa nga thirrjet kryesore që protestuesit kanë brohoritur në kor gjatë tubimit./**Dosja.al**

1 ORE ME PARE

Pas fjalimeve para kryeministrit qytetarët marshojnë në rrugët e Tiranës, thirrje në kor: Nuk shitet Shqipëria, shitet qeveria

"Nuk shitet Shqipëria"/ 99 ditë revoltë,
pamjet

TIRANË- Pas përfundimit të fjalimeve para Kryeministrit, qytetarët kanë vijuar marshimin rrugëve të kryeqytetit. Protestuesit janë zhvendosur nga kryeministria nëpër rrugët e Tiranës, duke

përcjellë mesazhe kundër qeverisë.

“Nuk shitet Shqipëria. Shitet qeveria”, “Dorëheqje”, “Ju erdhi fundi”, “Revolucion”, “Rama në burg, Berisha në burg” dhe “Nuk na përfaqësoni”, janë disa nga thirrjet që kanë brohorit në kor protestuesit.

Për 99 ditë me radhë, qytetarët janë mbledhur çdo pasdite në kryeqytet, duke zhvilluar tubime përpara Kryeministrit, Parlamentit, marshime në rrugët kryesore dhe duke përsëritur kërkesën për largimin e kryeministrit Edi Rama dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira./Dosja.al

2 ORE ME PARE

Aktivistja thirrje: Të martën te Parlamenti për t’ju thënë se nuk na përfaqësoni

 "Nuk shitet Shqipëria"/ 99 ditë revoltë,
Aktivistja Arvina Lleshi

HIRANË- Aktivistja Arvina Lleshi ka bërë thirrje për pjesëmarrje masive në protestën që shënon 100 ditë e saj, duke kërkuar dorëheqjen e Edi Ramës dhe të gjithë klasës politike. Aktivistja njoftoi gjithashtu se në datën 8, në orën 17:00, do të mbledhet pranë Parlamentit, për tu thënë deputetëve se nuk përfaqësojnë më popullin. Ajo e cilësoi Kuvendin si “Parlamentin e krimit”, duke përsëritur thirrjen për mobilizim qytetar.

"Nesër, në 100 ditë e protestës, i bëj thirrje të gjithë shqiptarëve të bashkohen në shesh. Të bashkohen për t'i kërkuar dorëheqjen Edi Ramës dhe gjithë klasës politike. Dorëheqje! Dorëheqje! Dorëheqje! Dorëheqje!... Më datë 8, në orën 17:00, takohemi te Parlamenti për t'ju thënë se “nuk na përfaqësoni”. Parlament i krimit. Parlament i krimit. Parlament i krimit...”, tha ajo./Dosja.al

2 ORE ME PARE

"Dy kërkesa janë urgjente, dorëheqja e Ramës dhe qeveria teknike"/ Protestuesi: Nesër 100-ditëshi, protestë kombëtare

 "Nuk shitet Shqipëria"/ 99 ditë revoltë,

HIRANË- Një protestues ka kritikuar qeverinë për menaxhimin e zjarreve, përmbajtjeve dhe situatës ekonomike, duke akuzuar institucionet për dështim në përballimin e problemeve të vendit. Duke iu referuar protestës që nesër shënon 100 ditë, ai bëri thirrje për mosbindje civile dhe paralajmëroi bllokimin e institucioneve dhe rrugëve. Protestuesi theksoi gjithashtu se dy kërkesat urgjente janë: Dorëheqjen e Edi Ramës dhe krijimin e një qeverie teknike.

"Sot dua të flas për situatën e krijuar në vendin tonë, ku kur vjen vera, ky vend digjet nga zjarret, sepse zjarrfikësja vonon 3 orë dhe në Fier u dogjën biznese dhe u rrezikuan jetë njerëzish. Digjet Himara turistike, sepse helikopterit i mbaron benzina rrugës. Dhe kur vjen dimri, vendi ynë shkrohet nga përmbytjet. Ku është shteti? Ky palo shtet që ka rënë me kohë. Ku është ky shtet kur nafta ka shkuar për 220 lekë për litër, kur ushqimet kanë shkuar në qiell, kur pensionet kanë shkuar në zero, kur ekonomia ka rënë, kur rinia largohet nga vendi.

Ku është ky shtet kur arsimi ka shkuar në zero dhe kur fëmijët janë përgjysmuar, kur klasa e parë nuk ka më fëmijë, kur mësuesit nuk kanë shkollë. Ku është ky shtet që nuk i përgjigjet kësaj proteste që vajti 100 ditë në këtë shesh? Nesër plotësojmë 100-ditëshin, ndaj i them të gjithëve, në protestë kombëtare! Të vazhdojmë mosbindjen civile, ndryshe këta nuk marrin vesh. Do vazhdojmë mosbindjen, do bllokojmë institucionet, rrugët dhe t'i detyrojmë të japin dorëheqjen. Ndaj mendoj se sot, ato 5 pikat që i kemi shpallur, dy të parat janë urgjente, Rama, jep dorëheqjen dhe qeveri teknike," tha protestuesi./Dosja.al

2 ORE ME PARE

"Duhet ta shkulim me rrënjë"/ Protestuesi: Rama ka shumëzuar me zero institucionet dhe ka krijuar partinë-shtet

 "Nuk shitet Shqipëria"/ 99 ditë revoltë,

HIRANË- Një protestues ka akuzuar qeverinë e Edi Ramës se po e zëvendëson rolin e institucioneve me strukturat partiake. Gjatë fjalës së tij, ai kritikoi “Praninë Besnike”, duke thënë se qytetarët po orientohen drejt partisë për probleme që duhet të zgjidhen nga Kadastra, arsimi apo institucionet e tjera shtetërore. Ai bëri thirrje për rrëzimin e kësaj qeverie, duke e krahasuar modelin aktual me periudhën e regjimit të Enver Hoxhës.

"Ajo që ka ndodhur këto ditë është ulëritëse. Qeveria që ka 13 vite në pushtet, e që ka hyrë në vitin e 14-të, po na thotë që problemet tona nuk i zgjidh shteti, nuk i zgjidh institucioni, por i zgjidh partia nëpërmjet "Pranisë Besnike". Ata i kanë hapur disa zyra dhe po na tregojnë se problemet tona, në rast se ne kemi një problem me pronën, nuk duhet të shkojmë te Kadastra, por te zyra e partisë. Nëse ke një problem me arsimin, kopshtet, nuk duhet të shkojmë te drejtoria rajonale, por duhet të shkojmë te zyra e partisë.

Pra, kjo qeveri, me zë, figurë dhe veprime, e ka njëshuar shtetin me partinë. Pra, e ka shumëzuar me zero çdo institucion shtetëror dhe mendon që të shkojmë te deputeti i zonës që kemi një hall, dhe deputeti të hyjë mik te Kadastra që të marrim certifikatën e pronësisë, atë që na takon. Pra këta, për 99 ditë, jo që nuk kanë reflektuar, por janë bërë edhe më agresivë në filozofinë e tyre politike, të partisë-shtet. Këtë parti-shtet që Edi Rama ka krijuar së bashku me qeverinë e tij dhe që e ka perfeksionuar me deputetë e sistemit e patronazhimit, ne duhet ta shëmbim. Ne duhet ta shkullim me rrënjë, sepse në rast se këta vazhdojnë të jenë në pushtet edhe për disa muaj, edhe për disa vite, shteti do të zhduket dhe, njësoj si në kohën e Enver Hoxhës, do të jetë një alternativë, Partia e Punës, pasardhëse e të cilës është Partia Socialiste," tha protestuesi./Dosja.al

3 ORE ME PARE

99 ditë revoltë kundër qeverisë Rama/ Qytetarët marshojnë drejt kryeministrit: Rama jepe dorëheqjen (VIDEO)

 "Nuk shitet Shqipëria"/ 99 ditë revoltë, pamjet

TIRANË- Qytetarët pas organizimit në sheshin Skënderbej, kanë nisur marshimin drejt Kryeministrit. Me thirrjet "Rama jepe dorëheqjen", "arrestoni Ramën", qytetarët po vijojnë marshimin në protestën e 99 kundër qeverisë.

Qëndresa, e cila ka hyrë tashmë në muajin e katërt, vijon me kërkesën kryesore për dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama, ndërsa protestuesit kërkojnë edhe ndryshim të sistemit politik./Dosja.al

3 ORE ME PARE

Dita e 99-të e protestës/ Nis organizimi i protestuesve në sheshin "Skënderbej"

 "Nuk shitet Shqipëria"/ 99 ditë revoltë,

TIRANA- Protestuesit kanë nisur organizimin në sheshin "Skënderbej", në ditën e 99 të revoltës së tyre kombëtare. Përmes këtyre protestave, ata kanë kërkuar plotësimin e disa kërkesave, ku e para është dorëheqja e kryeministrit Edi Rama nga qeveria.

Pas organizimit, ata do të zhvendosen drejt Kryeministrit, ku dhe do të zhvillojnë fjalimet e tyre. Protesta e tyre ka marrë jehonë kombëtare dhe ndërkombëtare, ndërsa të shumta kanë qenë mediat e huaja që i kanë kushtuar artikuj./Dosja.al

protesta kunder rames

Sondazh

Poll

editoriale

Editorial 3 Shtator 2026, 07:38 Enver Robelli

Pse po rebelohen deputetët e LDK-së

Enver Robelli Të “rebeluarit” e LDK-së vetëm duhet t’u tregojnë qytetarëve se për çka po “rebe...

Editorial 31 Gusht 2026, 16:22 Andi Bejtja

Make Albania Affordable

Andi Bejtja Nuk ka nevojë të shikosh të dhënat e Eurostat ku nenvizohet se cmimet e ushqimeve ne Shqipëri janë rritur 5 here me shume se mesatarja evropian...

Në vëmendje

Aktualitet 6 Shtator 2026, 20:56 E. D

PAMJE dramatike nga zjarri në Tërbun të Pukës, flakët shkrumbojnë masivin pyjor

pamjet TIRANË- Pamje dramatike janë publikuar nga zjarri në masivin pyjor të Tërbunit, mbrëmjen e sotme. Siç shih...

Art&Argëtim 6 Shtator 2026, 16:58 E.M

“The One About Matthew Perry”/ Nga Chandler Bing te betejat personale, Netflix dokumentar për aktorin ikonik të F.R.I.E.N.D.S

SHBA- Matthew Perry, aktori më i dashur amerikano-kanadez, i njohur më së miri për rolin ikonik të Chandler Bing (1994–200...

Aktualitet 6 Shtator 2026, 15:43 E. D

Nga “Boragji” te “Vis Korçari”/ Kush janë të arrestuarit e operacionit anti-drogë në Sarandë, të përfshirë në drogë, plagosje e vjedhje

SARANDË- Një operacion anti-drogë në Sarandë çoi në kapjen e 20 persona, mes tyre edhe 49-vjeçarin Altin Arap...

më të klikuarat

Politike 6 Shtator 2026, 09:56 I.A

"Ja ku ka gabuar SPAK"/ Rama përballë 300 pyetjeve: S’kam ndërmend të zgjedh pasardhës!

Edi Rama TIRANË- Kryeministri Edi Rama ka paralajmëruar rinisjen e podcastit të tij “Flasim”, me një intervistë ndrysh...

Aktualitet 6 Shtator 2026, 14:59 E. D

Përplasja e biznesmenëve në Vlorë/ Gjykata jep masat e sigurisë për të arrestuarit, Luan Muçës i caktohet “detyrim paraqitjeje”

VLORË- Gjykata e Vlorës ka dhënë masat e sigurisë për pesë personat e arrestuar në lidhje me ngjarjen e ndod...

Bota 6 Shtator 2026, 10:42 I.A

Irani u kundërpërgjigjet sulmeve amerikane, sulmojnë dronin detar amerikan

IRAN- Irani tha të dielën se forcat e tij sulmuan një dron detar amerikan që po përpiqej të hynte në Ngushticën e Horm...

Aktualitet 6 Shtator 2026, 15:52 E. D

Përplasja me Vasil Bedinajn, Luan Muça tregon versionin e tij të ngjarjes: Historia e gjobës është e sajuar

Luan Muça VLORË- Pronari i Delta Group, Luan Muça ka treguar versionin e tij lidhur me përplasjen me biznesmenin, Vasil B...

insights

Insights 2 Shtator 2026, 10:34 Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Idriz Konjari Shqipëria po hedh hapa të sigurt drejt integritimit në Bashkimin Evropian, por do të ishte gabim që integrimi evropian t&eu...

Insights 28 Gusht 2026, 21:11 Bledian Koka

[**Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?**](#)

I strukur ne nje qeli te IEVP Durres, nen "shoqerine" e gardianit te turnit, Erion Veliaj ka arritur te siguroje nje leter zyrtare te cilen ka hedhur per te d...

Insights 19 Gusht 2026, 11:08 **Fjola Graçi**

[**REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e “burrave të zinj”**](#)

TIRANE- Pamje të shëmtuara, të neveritshme, rrëqethëse për dikë dhe “anormale” për një tjetër. K...

Insights 13 Gusht 2026, 16:08 **cim peka**

[**Kur salla kthehet në pasqyrën e liderit**](#)

Mbushia e sallës së Kuvendit me përfaqësues të diasporës duhej të ishte një demonstrim force për Albin Kurtin. Po...

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.